

**Faqja e parë:**

**Foto: hapësirë e zbrazur**

**Citat : hapësirë e zbrazur**

**Nënshkrim: hapësirë e zbrazur**

**Titulli: Bota nuk është e barabartë. A është kjo e drejtë?**

Lënda: Edukim Qytetar, Shkenca Shoqërore

Mosha: 11-14 vjeçare

Koha: 60 minuta

Qëllimet për Zhvillim të Qëndrueshëm – (QZHQ):

- Qëllimi 1- Zhdukja e varfërisë
- Qëllimi 2 – Zhdukja e urisë
- Qëllimi 3 – Shëndeti i mirë
- Qëllimi 4 – Arsimi cilësor
- Qëllimi 5 – Barazia gjinore
- Qëllimi 6 – Uji i pastër dhe instalime hidrosanitare
- Qëllimi 7 – Energji e pastër
- Qëllimi 8 – Puna të mira dhe rritje ekonomike
- Qëllimi 10 – Zvogëlim të pabarazive

*Nëse futeni më thellë dhe e shikoni shumicën e synimeve specifike dhe objektivave të këtyre qëllimeve, do të vëreni se shumë sosh kanë të bëjnë me barazinë e qasjes së të gjithë njerëzve, pavarësisht nga sfondi i tyre, gjinia ose paaftësia.*

Qëllimet mësimore:

- Të dihet se ekzistojnë tipa të ndryshme të pabarazisë

- Të prezantohet një argument konciz dhe bindës i bazuar në hulumtim
- Të hulumtohet ndikimi që mund të ketë pabarazia në shoqërinë dhe ekonominë më të gjerë

Përgatitja e mësimit:

- Në aktivitetin hyrës mblidhni një sasi të mjaftueshme të biskotëve, sheqerkave, ngjitëseve, pullave, gurëve ose gjithçka tjetër që është e vogël, por në sasi të madhe
- Lexoni shtojcën 1
- Lexoni shtojcën 2 dhe vendosni nëse dëshironi t'i përdorni këta ide dhe t'i fusni në aktivitetin e parë
- Shtypni shtojcën 3
- Paraqitni tullumbacet me tekst të dhëna në shtojcën 3
- Shtypni informacionet për nxënësit të dhëna në Shtojcën 4

Koha	Aktiviteti mësimor	Diferencimi dhe alternativat
10 minuta	<p>Kur të futen nxënësit në klasë, shpërndajuni disa sheqerka/biskota/ngjitëse por në mënyrë të pabarabartë. Disa nxënës duhet të marrin shumë, ndërsa disa të tjerë nuk duhet të marrin asnjë. Pjesën më të madhe të sheqerkave/biskotave/ngjitëseve mbani për vete.</p> <p>Pasi të ulen të gjithë nxënësit parashtrojuani pyetjen: “A është kjo e drejtë?”</p> <p>Inkurajoni nxënësit të bisedojnë për këtë në nivel të klasës, gjegjësisht të diskutojnë sesi ndjehen në lidhje me sasinë e sheqerkave/biskotave/ngjitëseve që iu janë dhënë.</p> <p>Shpjegojuni nxënësve se ju për vete keni ndal pjesën më të madhe, për shkak se jeni më i/e vjetër. Pyetni nxënësit a është e drejtë një gjë e tillë dhe bën që edhe njëherë t’i redistribuoni sheqerkat/biskotat/ngjitëset sipas kësaj ndarje?</p> <p>Prezantoni idenë e pabarazisë shoqërore si temë e këtij mësimi. Ky definicion mund të jetë i dobishëm: <i>“situata në të cilën njerëzit nuk janë të barabartë, për shkak se disa grupe kanë më shumë mundësi, pushtet, para dhe gjëra të tjera sesa njerëzit tjerë”</i> (fjalori MacMillian)</p>	<p>Me qëllim që të inkurajoni diskutim të mëtejshëm në lidhje me pabarazitë, shqyrtoni mundësinë e zgjerimit të aktivitetit. Shtojca 2 e paraqet përvojën e këtij mësimi, madje ofron zgjerim të aktivitetit, duke përdorë sheqerka për ta prezantuar idenë e pabarazisë së nxënësve. Në këtë lidhje interneti (link) detajisht është përshkruar ky aktivitet</p> <p><a href="http://www.theguardian.com/teacher-network/2015/jan/28/teach-students-equality-smarties">http://www.theguardian.com/teacher-network/2015/jan/28/teach-students-equality-smarties</a></p>

10 minuta	<p>Prezantoni nxënësit me deklaratat <i>e saktë</i> ose <i>jo e saktë</i> rreth formave të ndryshme të pabarazisë të dhëna në shtojcën 3. Kërkoni nga nxënësit të punojnë individualisht, që të vendosin nëse secila deklaratë është e saktë ose jo e saktë.</p> <p>Tani prezantoni nxënësve përgjigjet faktike. Pastaj vazhdoni me diskutim në lidhje me deklaratat.</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• A kishte ndonjë deklaratë, e cila i ka befasuar nxënësit?</li> <li>• A kishte deklarata për të cilat konsideruan se duhet të ndryshojë situata?</li> <li>• Çka kanë mes vete të përbashkët të gjitha deklaratat?</li> </ul> <p>Përdoreni pyetjen e fundit që do t'u shpie në hyrjen e pjesës sesi pabarazia mund të ketë shumë forma.</p>	
5 minuta	<p>Paraqitni tullumbacet me deklarata (shtojca 3) të cilat i mbajnë nxënësit vullnetarë të cilët qëndrojnë rreth klasës. Kërkoni nga nxënësit t'i lexojnë deklarata dhe të ndalen pranë deklaratës, me të cilën më së shumti identifikohen ose pajtohen.</p> <p>Kërkoni nga disa nxënës t'i shpjegojnë zgjedhjet e tyre.</p>	
20 minuta	<p>Ndani nxënësit në grupe të vogla, që të përgatisin një prezantim në lidhje me një sferë të pabarazisë (mund të përcaktoni njerëz varësisht nga deklarata para të cilës janë ndalur në aktivitetin paraprak, mirëpo kjo kërkon shpërndarje të barabartë të nxënësve). Nxënësit mund ta përdorin informacionin në shtojcën 4 dhe burimet tjera të informacioneve në të cilat kanë qasje – gazeta, internet etj.</p> <p>Prezantimi i tyre duhet të zgjasë një minutë dhe në të duhet të shpjegohen se pse pabarazia është çështje serioze.</p>	<p>Nxënësit mund ta shndërrojnë fletën e shënuar për prezantim në një ditë të shkurtër të jetës së një personi, i cili përjeton pabarazitë. Ata duhet të përshkruajnë se si mund të jetë ndjerë personi në fjalë, vështirësitë me të cilat ai do të përballej, luftën e përditshme, problemet të cilat i parashikojnë për te ardhmen etj.</p> <p>Ky aktivitet duhet të trajtohet me ndjeshmëri, me qëllim që të shmangen stereotipat për grupe të njerëzve.</p>
10 minuta	<p>Nxënësit votojnë për pabarazitë me të cilat besojnë se ka gjasa të përballen dhe/ose do të mësojnë më shumë.</p> <p>Nxënësit nuk mund të votojnë për pabarazinë e prezantuar.</p>	

	<p>Brenda grupeve të vogla pyetni nxënësit të krijojnë “një zinxhir të ndikimit” për pabarazinë për të cilën ka votuar klasa. Nxënësit duhet t’i shkruajnë ndikimet, për të cilat mund të mendojnë se do të shfaqen si rezultat i pabarazisë.</p> <p>Udhëzoni nxënësit duke kërkuar prej tyre të mendojnë në lidhje me individët, familjet, bashkësinë lokale, shtetin, madje edhe në nivel global. Ata njashtu mund të mendojnë rreth ndikimeve ekonomike, shoqërore, politike dhe atë ndaj mjedisit jetësor.</p> <p>Shembuj për qasje jo të barabartë në hapësirë të gjelbër mund të jenë –</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• <i>Njerëzit janë më pak të shëndetshëm, nëse janë të rrethuar nga ndërtesa dhe makina.</i></li> <li>• <i>Njerëzit janë më pak të shëndetshëm, nëse kanë më pak hapësirë për të bërë ushtrime.</i></li> <li>• <i>Fëmijët nuk mësojnë për bimët, kafshët e egra dhe stinët.</i></li> <li>• <i>Fëmijët nuk kanë hapësirë të lirë dhe të sigurt për të lozur.</i></li> <li>• <i>Rrugët e asfaltuara janë të fëlliqura, andaj njerëzit nuk kanë vend, ku t’i shëtisin qentë e tyre.</i></li> <li>• <i>Më shumë para të shpenzuara për kujdesin shëndetësor, pasi njerëzit janë më pak të shëndetshëm dhe sëmuren më shpesh.</i></li> <li>• <i>Familjet, të cilat jetojnë në shtëpi të vogla janë më të stresuara dhe më pak të lumtura, pasi nuk kanë hapësirë për t’u relaksuar.</i></li> <li>• <i>Më shumë përmbajtje pasi të reshurat e shiut futen në kanalet e ujërave të zeza dhe shumë më shpejtë depërtojnë në lumenj, pa u ngadalësuar nga bari dhe drunjtë.</i></li> </ul>	
5 minuta	<p>Kërkoni nga nxënësit t’i kompletojnë fjalitë “Pabarazia nënkupton...”.</p> <p>Ju mund ta strukturoni këtë duke e kufizuar numrin e fjalëve, të cilat i përdorin ose duke insistuar se ata mund të përfshijnë shembuj nga jeta reale.</p>	Si alternativë nxënësit do të mund të vizatojnë diçka, që ata konsiderojnë se e prezanton pabarazinë në njëfarë mënyre.
<p><b>Aktiviteti vijues</b> Pas përfundimit të mësimit, nxënësit do të mund të identifikojnë diçka që përfaqëson pabarazi në mjedisin lokal, madje edhe gjatë rrugës së tyre për në</p>		

shtëpi. Ata mund të bëjnë një fotografi ose të shënojnë një përshkrim të shkurtër e pastaj të shpjegojnë se pse atë që e kanë parë ata, shkakton grupe të ndryshme të njerëzve të jenë të pabarabarta.

Për shembull:

- Kaçubet dhe shkurret që rriten mbi rrugët e shtruara e pengojnë lëvizjen e personave me shikim të dëmtuar
- Shkallët në ndërtesa publike ose hapësirë e pengojnë lëvizjen e personave me karrocë invalidësh, karrocë me shtyrje, ose të personave me vështirësi në të ecur;
- Shitoret ose hapësirat e gjelbra në të cilat mund të depërtohet vetëm me makinë, që do të thotë se personat të cilët lëvizin me transport publik nuk mund të kenë qasje (zakonisht shumica e tyre janë persona të vjetër ose të papunësuar)

## **Formulari *Thirrje për veprim***

### **Shtojca 1**

#### **Me rëndësi!**

Para se të zhvilloni këtë mësim duhet të kontrolloni nëse ndonjë nga nxënësit tuaj është i prekur nga ndonjëra prej këtyre pabarazive. Këta janë tema të ndjeshme, andaj që të mund t'i diskutoni ato hapur dhe në mënyrë miqësore duhet të përkujdeseni që klasa të jetë mjedis i sigurt për të gjithë nxënësit tuaj.

Ky mësim është hyrje në disa nga shumë llojet e pabarazisë, të cilat ekzistojnë në botë. Kur përshkruhen këta situata, lehtë mund të bihet në stereotipa. Përkujdesuni t'i mbani nxënësit më larg kësaj dhe përkujtoni ata se ka shumë gjëra të ndërlikuara për arsyen pse ekzistojnë pabarazi dhe si ndjehen njerëzit që jetojnë në rrethana të tilla.

# Si i mësoj nxënësit për pabarazitë: vetëm fëmijët me sheqerka (*smarties*) kanë përgjigje

*Agnes Arnold-Forster e ndan me të tjerët mësimin e saj më të mirë, si i përfshin nxënësit në debat në lidhje me padrejtësinë dhe barazinë me ndihmën e gostitjes me çokolata.*

Secilit që i është dhënë rasti të punojë ose të jetojë me fëmijë, do të mësojë se mundësia e fëmijëve të detektojnë padrejtësi është mjaft e zhvilluar – zakonisht ata thonë “nuk është e drejtë”. Sidoqoftë ne rrallëherë kërkojmë ta kanalizojmë këtë dhunti të natyrshme për drejtësi në diskutim produktiv dhe kritik në lidhje me natyrën e barazisë, çka përbën trajtim të drejtë dhe kush i definon standardet e tilla.

Unë para do kohësh i mësoja katër grupe të vogla të nxënësve të moshës 5 dhe 6 vjeçare nga dy shkolla në Romford si pjesë e [Brilliant Club](#) (Klubi Brilliant), një organizatë jofitimprurëse, e cila i trajnon dhe vendos studentët e doktoratës në shkolla joselektive dhe kolexe të shkallës së gjashtë për të ofruar mentorim grupeve të vogla të nxënësve të jashtëzakonshëm sipas formës së punës universitare. Me këtë synohet të shtrihet qasja në universitetet më të mira, të rriten aspiratat dhe të trajtohen dobësitë e arsimit. Si studente e doktoratës kisha përvojë t’iu mbaj mësim personave të moshës 20 vjeçare, të cilët përballen me sfidat e veta, mirëpo askush nuk është orvatur t’i përfshijë fëmijët e moshës 9 dhe 10 vjeçare.

Ky mësim bazohet në 2 programe të shkallës kyçe, të cilat hulumtojnë mënyra të shumta të të menduarit rreth drejtësisë, barazisë dhe drejtësisë shoqërore. Programi është paraparë të zhvillohet sipas seminareve të punës universitare, ashtu që filluam të themelojmë disa udhëzime sesi do të bashkëveprojmë: heshtje në shenjë respekti kur flet ndokush tjetër, mospajtimet të shprehen në formë të qytetëruar, madje këtë kontekst kam sugjeruar se ne nuk do të duhet ta **ngrisim** dorën për t’i ndarë me të tjerët opinionet tona. Sidoqoftë privilegji kryesor lehtë mund të anulohet, nëse nxënësit nuk iu përmbahen rregullave tjera.

Unë e fillova mësimin duke ua ndarë nxënësve disa sheqerka – më së mirë vetë vendosni se çka të përdorni, për shkak se përndryshe do ta futni veten në kritika. Unë zgjodha sheqerka *smarty*. Disa fëmijëve iu dhashë 15, ndërsa të tjerëve vetëm nga një. Shumicën e ndala për vete. A ishte kjo e drejtë? Fëmijët filluan të ndjehen të dëshpëruar. Kërkova prej tyre t’i shënojnë ndjenjat e tyre në lidhje me sasinë e sheqerkave që kanë marrë. Disa ishin “të shqetësuar”, “të dëshpëruar” dhe “të hidhëruar”. Të tjerët ishin “të kënaqur” dhe “të lumtur”. Disa më besnikë ndjeheshin “të dëshpëruar” se shpërndarja ishte e padrejtë, pavarësisht se vetë kishin marrë sasi të bollshme të sheqerkave.

Unë i pyeta si do të mund t’i shpërndajmë që ndarja të jetë e drejtë. Ata të gjithë u pajtuan se të gjithë duhet të marrim numër të barabartë të sheqerkave. Pra deri më tani lehtë mund të parashikohet: drejtësia nënkupton barazi. Ky format i thjeshtë mund po ashtu të përdoret për të testuar forma tjera të interpretimit të trajtimit të drejtë. Në cilat situata pabarazia mund të jetë përafrim më i mirë i drejtësisë?

Unë e ndava grupin përgjysmë – në njërin anë ishin “fëmijët”, ndërsa në anën tjetër ishin “të rriturit”. Kush duhet ta merr pjesën më të madhe të sheqerkave *smarty*? Kishte sugjerime nga më të ndryshmet, por shumica u pajtuan se fëmijët duhet të marrin më shumë, për shkak se dëshironin më

shumë. Të rriturit ishin të interesuar në gjëra tjera, siç është puna, kompjuterët dhe sukcesi i fëmijëve të tyre në shkollë. Pra drejtësia mund të nënkuptojë lumturi të barabartë, e jo shpërndarje të barabartë.

Andaj unë iu dhashë “të rriturve” të holla dhe e përcaktuam çmimin më të lartë: një *smarty* për një peni. Grupi i fëmijëve përsëri u inatos. Si mund fëmijët të paguajnë, kur nuk kanë të holla?

Ne vazhduam me disa skenarë shumë më sfidues. Sipas skenarit tjetër të gjithë nxënësit u bënë persona të rritur, por vetëm gjysma prej tyre kishin të holla për t’i blerë sheqerkat. A ishte e drejtë? Për herë të parë u përballa me opinione kundërtë. Disa sugjeronin se ata që kanë të holla, ndoshta kanë punuar për sheqerkat, andaj edhe më shumë i meritojnë. Të tjerët pretendonin se unë ua kam ndarë të hollat në mënyrë arbitrare, pra nuk e dimë nëse kanë punuar me mundim ose thjesht u është dhënë një avantazh i padrejtë.

Disa sugjeronin se megjithatë sheqerkat *smarti* duhet të ndahen në mënyrë të barabartë, pavarësisht nga potenciali për shpenzim. Ose ndoshta duhet të ketë sasi minimale, të cilën duhet ta merr secili, ndërsa disa më me fat do të mund të marrin më shumë sheqerka nëse blejnë më tepër?

Këta skenarë të ndryshëm me *smarti* kanë disa paralele të paqëndrueshme për situata të jetës reale, andaj nxënësve iu duk si provokim i vogël kërkesa për ndërlidhjen e skenarëve me situatë të jetës reale. Ne folëm për fëmijërinë – rolin dhe përgjegjësinë e tyre në shoqëri në raport me atë të prindërve të tyre. Ne diskutuam për sakrifikimin e lumturisë personale për hir të harmonisë së grupit dhe debatuam për vlerën e punës – nëse ka nevojë të shpërblehet ose jo. Biseduam njashtu për nevojat dhe dëshirat e ndryshme të njerëzve dhe për varfërinë. Ne po ashtu debatuam nëse drejtësia ka qenë aspekti më i rëndësishëm i shoqërisë. Folëm nëse zbatimi i drejtësisë nganjëherë i komprometon liritë individuale? A mund ta zbatojmë diskutimin tonë të vogël grupor në botën reale?

Poenta e këtij mësimi nuk është të ofrohen përgjigje, por të nxiten debate. Kjo funksionoi mirë me nxënësit e mi – ata ishin e entuziast dhe çmuar këto formë të punës. Përderisa diskutimi nganjëherë binte në kaos të lehtë (pa dyshim nga energjizimi i drejtpërdrejtë me sheqer) nganjëherë harrohej të respektimi i rregullit, që të mos i ndërpritet fjala personit që flet, megjithatë ky pasion ishte produktiv, andaj nxënësit ishin në gjendje të bëjnë interpretime jashtëzakonisht të sofistikuara. Sidoqoftë ky mësim mund të jetë më i përshtatshëm për punë me grupe të vogla, sesa për punë me të gjithë klasën.

Ajo që është në veçanti interesante për këtë mësim, është fakti se ai do të ndjek në mënyrë dramatike një rrjedhë të ndryshme varësisht nga shkolla dhe nxënësit e klasës. Nxënësit e vegjël nuk janë qenie të pasocializuara: ata janë të informuara për kontekstin e tyre social dhe kulturor – shumë më të dukshëm me atë të prindërve të tyre. E tërë kjo ishte temë diskutimi gjatë bisedës sonë. Megjithatë pavarësisht nga rrethanat ky mësim iu mundësoi nxënësve të bisedojë dhe të vënë në pyetje ide dhe besime, të cilat me siguri më parë nuk i kanë shqyrtuar. Ata u gjeruan përtej ndjenjave të tyre për dhunën individuale dhe kuptimin për shoqërinë në tërësi. Mësimi është vetëm një mënyrë për ta në ndërtimin e sistemit të tyre të vlerave dhe të mendojnë sesi ato mund të vijnë në konflikt me atë që e imponon shoqëria.

### Shtojca 3

## E saktë ose jo e saktë?

1. 85 personat më të pasur në botë kanë më shumë pasuri sesa gjysma e gjithë banorëve të varfërve të botës, të cilët janë 3.5 miliard banorë.
2. Në SHBA vlera mesatare e amvisërive të bardha në vitin 2009 ka qenë 113,149 dollarë, në krahasim me amvisëritë afro-amerikane me 5,677 dollarë dhe atyre hispanike me 6,325 dollarë.
3. 80% të personave me paaftësi jetojnë në shtete më pak të zhvilluara.
4. Në shtetet më të zhvilluara shkalla e papunësisë së personave me paaftësi është së paku dy herë më e madhe sesa ajo e personave që nuk kanë ndonjë paaftësi.
5. Në Amerikën Latine 80-90% të personave janë të papunësuar ose nuk janë të përfshirë në tregun e punës, ndërsa Shumica e atyre, që janë të punësuar marrin rroga të ulëta ose fare nuk paguhen.
6. Deri në vitin 2040 llogaritet se më shumë se një e katërta e evropianëve pritet të jenë së paku 65 vjeç.
7. Në Mbretërinë e Bashkuar shkalla e papunësisë për personat e moshës 16-24 është 14.4%. Shkalla e përgjithshme e papunësisë është 5.7%.
8. Në nivel global gratë mbajnë më pak se një të katërtën e të gjitha ulëseve në parlament.
9. Në Mbretërinë e Bashkuar gratë dy herë më shumë se burrat varen nga ndihma e shtetit.
10. Në Mbretërinë e Bashkuar dy të tretat e pensionistëve që jetojnë në varfëri janë gra.
11. Në Evropë qasja e lehtë në hapësirë të gjelbër për disa nivele e përmirëson shëndetin e banorëve të varfër deri më 40%.
12. Në SHBA njerëzit, të cilët jetojnë afër transportit publik për tre herë më shumë se të tjerët mund të gjejnë vende pune.



### Shtojca 3

## E saktë ose jo e saktë? Shënimet e arsimitarit

85 personat më të pasur në botë kanë më shumë pasuri sesa gjysma e gjithë banorëve të varfërve të botës, të cilët janë 3.5 miliard banorë.

**E saktë.** Nga raporti i Oksfam Mbretëria e Bashkuar nga viti 2014. Më shumë mund të lexoni nga raporti i tyre në: <http://www.theguardian.com/business/2014/jan/20/oxfam-85-richest-people-half-of-the-world>

---

Në SHBA vlera mesatare e amvisërive të bardha në vitin 2009 ka qenë 113,149 dollarë, në krahasim me amvisëritë afro-amerikane me 5,677 dollarë dhe atyre hispanike me 6,325 dollarë.

**E saktë.** <http://inequality.org/99to1/facts-figures/>

---

Tetëdhjetë për qind të personave me paaftësi jetojnë në shtete më pak të zhvilluara.

**E saktë.** Programi për zhvillim i OKB-së. <http://www.disabled-world.com/disability/statistics/>

---

Në shtetet më të zhvilluara shkalla e papunësisë së personave me paftësi është së paku dy herë me e madhe sesa ajo e personave që nuk kanë ndonjë paftësi.

**E saktë.** Forumi i biznesit për persona me paftësi. <http://businessdisabilityforum.org.uk>

---

Në Amerikën Latine 80-90% të personave janë të papunësuar ose nuk janë të përfshirë në tregun e punës, ndërsa Shumica e atyre, që janë të punësuar marrin rroga të ulëta ose fare nuk paguhen.

**E saktë.** Banka Botërore, "Zhvillimi dhe inkluzioni i personave me paftësi: Amerika Latine dhe Karaibet, 2004.

---

Deri në vitin 2040 llogaritet se më shumë se një e katërta e evropianëve pritet të jenë së paku 65 vjeç.

**E saktë.** Byroja e SHBA-ve regjistrim, 2008. <http://www.efa.org.uk/pages/older-people-global-perspective-.html>

---

Në Mbretërinë e Bashkuar shkalla e papunësisë për personat e moshës 16-24 është 14.4%. Shkalla e përgjithshme e papunësisë është 5.7%.

**E saktë.** Zyra Shtetërore e Statistikës, 2015.

<http://www.theguardian.com/society/2015/feb/22/youth-unemployment-jobless-figure>

---

Në nivel global gratë mbajnë më pak se një të katërtën e të gjitha ulëseve në parlament.

**E saktë.** Unioni ndërparlamentar, 2015. <http://www.theguardian.com/global-development/datablog/2015/mar/08/international-womens-day-number-of-female-lawmakers-doubles-in-20-years>

---

Në Mbretërinë e Bashkuar gratë dy herë më shumë se burrat varen nga ndihma e shtetit.

**E saktë.** Mordaunt et al, 'One in Four', 2003.

---

Në Mbretërinë e Bashkuar dy të tretat e pensionistëve që jetojnë në varfëri janë gra.

**E saktë.** Mordaunt et al, 'One in Four', 2003.

---

Në Evropë qasja e lehtë në hapësirë të gjelbër për disa nivele e përmirëson shëndetin e banorëve të varfër deri më 40%.

**E saktë.** Qendra për Huluntim dhe Mjedis Jetësor, Shoqëria dhe Shëndeti, 2015. <http://fashion.telegraph.co.uk/article/TMG11551673/How-green-spaces-stop-the-wealth-gap-becoming-the-health-gap.html>

---

Në SHBA njerëzit, të cilët jetojnë afër transportit publik për tre herë më shumë se të tjerët mund të gjejnë vende pune në një milje katrorë.

**E saktë.** Asociacioni Amerikan i Transportit Publik, 2013.

<http://www.apta.com/resources/statistics/Documents/NewRealEstateMantra.pdf>

---

#### Shtojca 4

Unë besoj se barazia për meshkujt dhe femrat është e rëndësishme, për shkak se gratë e përbëjnë gjysmën e banorë të tokës, por shpeshherë ato janë të paguara më pak sesa meshkujt, më pak janë të përfaqësuara në qeveri dhe marrin më pak arsim sesa meshkujt. Duhet të tejkalohen barrierat që e pengojnë suksesin e femrave.

Llorenco, promotor i barazisë

Unë besoj se barazia e njerëzve të të gjitha përkatësive dhe etnive është e rëndësishme, për shkak se të gjithë njerëzit duhet të kenë mundësi të barabarta në jetë dhe të dinë se do të trajtohen drejt dhe me respekt, pavarësisht nga prejardhja e tyre, ngjyra e lëkurës ose besimi i tyre.

Heti, promotor i barazisë

**Shtojca 4**

Unë besoj se është e rëndësishme barazia e njerëzve pavarësisht nëse kanë ose nuk kanë ndonjë paaftësi, për shkak se secili duhet të mund të shkojë në shkollë, të punojë dhe të lëviz lirshëm në mjedisin e tij lokal. Të gjithë mund të kontribuojnë në shoqërinë tonë.

Çaku, promotor i barazisë

Unë besoj se barazia e njerëzve të të gjitha moshave është e rëndësishme për shkak se njerëzit e të gjitha moshave mund të kontribuojnë në shoqërinë dhe ekonominë tonë. Edhe të rinjtë edhe të vjetrit posedojnë shkathtësi, të cilat na nevojiten. Ne duhet të ofrojmë mundësi për të gjithë dhe të përkujdesemi, që askush të mos përjashtohet.

promotor i barazisë

#### Shtojca 4

Unë besoj se qasja e barabartë në arsim për të gjithë pavarësisht se kush janë ose ku jetojnë është e rëndësishme për shkak se secili meriton mundësi për të mësuar dhe për ta përmirësuar jetën e vetë, ndërsa në të gjithë do të kemi dobi, nëse secili posedon shkathtësi themelore dhe mund të kontribuojë në shoqërinë dhe ekonominë tonë.

Izabella, promotor i barazisë

Unë besoj se qasja e barabartë në parqe dhe hapësira të gjelbra është e rëndësishme për shkak se ne të gjithë kemi nevojë për vende për relaksim, për ushtrim dhe për qetësim. Këta hapësira nuk duhet t'i gëzojnë vetëm të pasurit. Secili ka dobi nga shoqëria më e shëndoshë dhe më e lumtur. Mbështetja shtesë e hapësirës së gjelbër i ndihmon edhe mjedisit jetësor!

Mai, promotor i barazisë

## Informacione për barazinë gjinore

### Arsimi

Femrat nuk kanë qasje të barabartë në arsim. Ndonëse janë ngushtuar dallimet ndërmjet gjinive në arsim, megjithatë kanë ngelë disparitete ndërmjet rajoneve në të gjitha nivelet e arsimit, në veçanti me grupet më të përjashtuara dhe të marginalizuara. Ka pasur progres të madh nëpër të gjitha rajonet në zhvillim për sa i përket shkuarjes në shkollë fillore.

Sidoqoftë femrat vazhdojnë të përballen me barrierat e shkollimit, në veçanti në Afrikën veriore, rajonin nën shkretëtirën e Saharës në Afrikë dhe në Azinë perëndimore. Edhe pse më shumë vajza tani e ndjekin shkollimin në rajonin nën shkretëtirën e Saharës në Afrikë, megjithatë në 100 djem regjistrohen vetëm 93 vajza.

Qasja në arsimin e mesëm dhe universitar ngel jashtëzakonisht i pabarabartë. Përmirësime të konsiderueshme janë bërë në Azinë perëndimore dhe në atë jugore, ndonëse ende femrat vazhdojnë të jenë në situatë të pafavorshme. Disparitetet janë më të mëdha në nivel universitar. Në Azinë jugore në arsimin sipëror në 100 djem regjistrohen vetëm 77 vajza. Situata është shumë më e rëndë në rajonin nën shkretëtirën e Saharës në Afrikë, ku dallimi i regjistrimeve mes gjinive është zgjeruar, pasi në vitin 200 në 100 djem janë regjistruar vetëm 66 vajza ndërsa në vitin 2011 në 100 meshkuj janë regjistruar vetëm 61 femra.

### Puna

Rrogat e grave të punësuar në sektorët tjerë përveç atë të bujqësisë kanë shënuar rritje të vogël nga 35% në 40% ndërmjet viteve 1990 deri në 2010, ndonëse ngel nën 20% në Azinë perëndimore, Afrikën veriore dhe Azinë jugore.

Gratë ende futen në tregun e punës në baza të barabarta me meshkujt, edhe pas llogaritjes së arsimit dhe shkathtësive. Ata shpeshherë angazhohen në forma vulnerable të punësimit, me pak ose pa sigurim financiar ose beneficione sociale, në veçanti në Azinë perëndimore dhe në Afrikën veriore, ku janë të kufizuara mundësitë për pagesë të grave.

Në nivel botëror gratë mbulojnë vetëm 25% të posteve të menaxherëve seniorë.



## Shtojca 5

# Informacione për barazinë e moshës

Ageism (ejxhizmi) paraqet trajtimi jo të barabartë i personave duke u bazuar në moshën e tyre. Ai mund të ketë ndikim në besimin e ndokujt, perspektivën për punë, situatën financiare dhe cilësinë e jetës.

Po ashtu mund ta përfshijë edhe mënyrën sesi më të vjetërit paraqiten në media, gjë që mund të ketë ndikim më të gjerë në sjelljet publike.

Më të vjetërit mund të përjetojnë ...

- të humbin vendin e punës për shkak të moshës.
- t'iu refuzohet kredia pa interes, kartela e re kreditore, sigurimi i makinës ose sigurimi për udhëtim për shkak të moshës së tyre.
- pranimi i shërbimeve të cilësisë më të ulët në shitore ose restorant, për sjelljes së organizatës ndaj personave të vjetër.
- të mos jenë të përshtatshëm për ndihmë financiare për shkak të kufizimeve të moshës.
- t'iu refuzohet udhëzimi nga mjeku për të këshilltari sepse janë "shumë të vjetër".
- t'iu refuzohet anëtarësimi në një klub ose asociacion tregtar për shkak të moshës.

Të gjitha këta situata janë shembull të ageism-it (ejxhizmit). Ligji ju mbron nga disa prej këtyre situatave, por nga të gjitha.

## Shtojca 5

# Informacione për barazinë sipas aftësive

Llogariten rreth një miliard persona me paaftësi anekënd botës. 80 % prej tyre jetojnë në shtetet në zhvillim. Personat e paaftë janë zakonisht personat më të varfër në shoqëri, të cilët përjetojnë përjashtim social dhe diskriminim në të gjitha nivelet.

Personat me paaftësi përfaqësojnë 15% të popullsisë së botës.

### Në arsim

Fëmijët me paaftësi dhe të rinjtë janë disa ndër personat në situatë më të pafavorshme dhe më vulnerabilë në shoqëri anekënd botës. Ata shpeshherë janë të përjashtuar nga pjesëmarrja në jetën shoqërore dhe tepër vulnerabil ndaj moskujdesit dhe abuzimit. Fëmijët femra me paaftësi janë edhe më shumë të marginalizuara brenda familjeve dhe bashkësive të tyre si dhe mund të përballen me diskriminim të dyfishtë, për shkak të roleve dhe përgjegjësi tradicionale në raport me gjinitë.

### Në punë

Si gjithë ne, njerëzit me paaftësi kanë nevojë të punësohen që të kenë të ardhura për jetesë, të kontribuojnë në mbështetjen e familjeve të tyre dhe ta përmirësojnë vlerësimin për veten e tyre. Prapëseprapë më pak se 20% të personave me paaftësi aktualisht janë të punësuar.

### Në shoqëri

Arsimi inkluziv dhe inkluzioni përmes punës nuk mjaftojnë vetvetiu për integrim të plotë të njerëzve me paaftësi në bashkësitë e tyre. Qasja në informacione, aktivitete të lira, ndërtesa dhe infrastruktura janë njashtu mjaft të rëndësishme.

Personat me ndonjë paaftësi duhet të mund të hyjnë dhe të lëvizin nëpër shtëpi dhe nëpër hapësira dhe godina publike (biblioteka, vendvotime, shkolla, fusha sporti, qendra shëndetësore etj). Mjedis i përshtatshëm është po ashtu i favorshëm për personat me mobilitet të reduktuar siç janë fëmijët dhe të vjetrit.

## Shtojca 5

# Informacione për barazinë racore dhe etnike

Pabarazia etnike – rrethanat e pafavorshme të ndjera si rezultat i përkatësisë së grupeve racore minoritare – vazhdon anekënd globit.

### Shtetet më pak të zhvilluara

Anekënd botës ekziston një lidhje ndërmjet përkatësisë etnike dhe profesionit, ku disa punë jo vetëm që shikohen si status i ulët, por njashtu edhe si më pak të paguara dhe me më pak shpërblim. Sistemi indian i kastave është ndoshta shembulli më famëkeq. Ndonëse sistemi i kastave është ndryshuar qartë gjatë disa dekadave të fundit – praktika e segregacionit ekstrem e ndërlidhur me paprekshmërinë e ndalur në vitin 1905 – Dalitët ende më shumë ka gjasa të punojnë si pastrues të tualeteve sesa grupet tjera, madje shumë rrallë janë në cilësinë e kuzhinierëve për kastën më të lartë Hindu.

India është shtet me pabarazi të vazhdueshme etnike. Përderisa në përgjithësi varfëria është në rënie e sipër, ende janë në përgjithësi të larta shkallët e varfërisë për disa grupe si për shembull Adivasis (ose njerëzit “fisnor”, pasi 45% prej tyre jetojnë në varfëri në mjedise rurale, ndërsa 27% në mjedise urbane), Dalitët (ish të paprekurit, 34% prej tyre jetojnë në varfëri rurale, ndërsa 22% në varfëri urbane) dhe muslimanët (27% në varfëri rurale dhe 23% në varfëri urbane). Shkallët e varfërisë në mesin e kastës më të lartë Hindu për vitin 2011/2012 ka qenë 16% të atyre që jetojnë në mjedise rurale dhe 8% të atyre që jetojnë në mjedise urbane.

### Shtetet më të zhvilluara

Problemet ekonomike dhe politike të shkaktuara nga pabarazitë etnike nuk janë të kufizuara vetëm në sistemin e kastave në Indi. Në shumicë ne shteteve evropiane, imigrantët e rinj shpeshherë punojnë në kushte të pasigurta madje edhe eksploatuese, me rroga të ulëta, si dhe bëjnë punë cilat popullata vendase nuk preferon t’i punojë.

Ne e dimë së në Mbretërinë e Bashkuar për 12% është më i lartë proporcioni i shkallës së punësimit të britanikëve në raport me grupet e minoriteteve etnike. Kjo në shifra është rreth 500,000 punëtorë “në mungesë” në tregun e punë së Mbretërisë së Bashkuar. Të dhënat e departamentit të punës dhe pensioneve tregojnë shkallën e papunësisë prej 45% në vitin 2013 për të rinjtë zezakë, pakistanez, bangladeshian, ndërsa 19% për banorët e racës së bardhë. Shtetet tjera evropiane përjetojnë sfida të ngjashme, qoftë në lidhje me rrogat e ulëta dhe diskriminimin ndaj imigrantëve, ose vazhdimin e pasojave të këtij diskriminimi në gjeneratën e dytë ose edhe të tretë të minoriteve etnike të lindura në Evropë.

## Shtojca 5

# Qasja e barabartë në hapësirë të gjelbër

Njerëzit e ekspozuar në mjedise të cilësisë së ulët kanë më shumë gjasa të kenë shëndet të ligë sesa njerëzit, të cilët jetojnë në mjedis cilësor.

Ekzistojnë shkallë të ulëta të mortalitetit ndaj të gjitha grupeve që jetojnë në mjedise me gjelbërim.

Në përgjithësi mjedisi i hapur ofron platformë për aktivitete të bashkësisë, bashkëveprim social, aktivitet fizik dhe rekreacion, po ashtu ndihmon në reduktimin e izolimit social, përmirësimin e kohezionit të bashkësisë dhe ndikimin pozitiv në më shumë përcaktues të shëndetit. Për shembull, ka dëshmi të lidhjes ndërmjet kapitalit shoqëror – siç është puna vullnetare, besimit në bashkësi, sigurisë sociale dhe shëndetit, përfshirë faktorët mbrojtës nga sëmundjet mendore dhe dobësimi aftësive kognitive mbi moshën 65 vjeçare, që kanë të bëjnë me pjesëmarrjen shoqërore dhe fuqizimin e bashkësisë.

Dëshmitë për dobitë shëndetësore si rezultat i hapësirës së gjelbër janë gjithandej të pranuar, duke përfshirë ndërlidhjen pozitive me shëndetin në përgjithësi, dobitë shëndetësore të ndërlidhura me nivelet më të larta të aktivitetit fizik, përmirësimin e shëndetit mendor dhe mirëqenies si dhe efektet pozitive fiziologjike të mjedisit më të mirë dhe më cilësor.

Hapësira e gjelbër ndihmon për përmirësimin e shëndetit në përgjithësi. Hulumtimet bëjnë me dije se hapësira e gjelbër mund të përmirësojë cilësinë e mjedisit jetësor me efekt në: përmirësim të cilësisë së ajrit dhe ujit, absorbimi i zhurmës është njashtu një ndër dobitë e mjedisit jetësor, që mund ta ofrojë hapësira e gjelbër. Përveç kësaj, hapësira e gjelbër mund ta përmirësojë absorbimin e të reshurave të mëdha të shiut, pasi vegjetacioni i ndërpret të reshurat e shiut, lagështinë e ajrit, reduktimin shembjes së dheut e me të edhe të përmytjeve dhe derdhjes së ujërave të zeza, me çka mbrohet biodiversitetin dhe zhvillohet ekosistemi.